



REPUBLIKA E SHQIPERISË
KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË
DHËNAVE PERSONALE
DREJTORIA E ÇËSHTJEVE JURIDIKE

Nr. 1161 Prot
1

Tiranë, më 2/11 /2016

Lënda: Jepet mendim për projektligjin “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.10128, datë 11.05.2009 “Për tregtinë elektronike”, të ndryshuar”.

Drejtuar: **Znj. Milena HARITO**
MINISTËR SHTETI PËR INOVACIONIN DHE ADMINISTRATËN
PUBLIKE

Tiranë

E nderuar znj. Harito,

Në përgjigje të shkresës tuaj Nr. 6227 Prot., datë 26.10.2016, projektligji “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.10128, datë 11.05.2009 “Për tregtinë elektronike”, i ndryshuar”, vlerësohet i hartuar konform kërkesave të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, i ndryshuar.

Në komunikimet e mëparshme, nga ana jone është sugjeruar një rregullim për sa i përket regjistrit të përjashtimeve. Kjo është reflektuar në nenin 6 të projektligjit, duke shtuar pikat 4 dhe 5, por pa u reflektuar kjo edhe në nenet e tjera të ligjit.

Për këtë arsye, do të sugjeronim edhe rregullimet e mëposhtme:

1. Në shkronjën “gj” të nenit 3 të ligjit, të hiqen fjalët “*që ofruesi i shërbimit mban*”;

2. Në nenin 6 të projektligjit, të bëhet riformulimi i pikës 3,4 dhe 5 të nenit 9 të ligjit, si vijon:

“3. *Çdo ofrues i shërbimeve, që ofron komunikime tregtare të pakërkuara nëpërmjet postës elektronike dhe/ose sms, është i detyruar të kontrollojë rregullisht dhe të respektojë regjistrin e përjashtimeve që mbahet dhe administrohet nga Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale*”.

“4. Në rast mosrespektimi të regjistrit nga ofruesi i shërbimit apo dërgimit të komunikimeve tregtare pa marrë miratimin paraprak të personit, marrës shërbimi, ky i fundit ka të drejtë të ankohet pranë Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale”.

“5. Rregulla të hollësishme në lidhje me regjistrin e përjashtimeve për komunikimet e pakërkuara prej çdo personi, marrës shërbimi, përcaktohen me Udhëzim të Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale”.

3. Në shkronjën “c” të nenit 9 të projektligjit, që riformulon pikën 2 të nenit 21 të ligjit, të hiqen fjalët “7 dhe” për shkak se përkufizimet e nenit 7, pika 1 nuk lidhen me veprimtarinë e Zyrës së Komisionerit.

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin,

